



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

| | |
|--------------------------------|--|
| Datë/a: | 26.05.2021 |
| Referenc-ë: | 07-353/04-88055/21 |
| Për/ Za/ To: | “Instituti Profesional ATC” SH.P.K |
| Përmes/Preko/Through: | Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit |
| Nga/ Od/ From: | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit Pëlqim |



Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën tuaj me nr protokoll 07-353/04-88055/21 nga “Instituti Profesional ATC” SH.P.K me të cilën kërkohet që me datë 1 Qershor 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, dhe vendosja e një shtandi në Sheshin “Zahir Pajaziti”.

Qëllimi i aktivitetit është që fëmijëve tu ofrohen përgatitje të ndryshme dekorative ushqyese falas si nga pastiqeria po ashtu edhe nga kuzhina të përgatitura nga Profesorët dhe Studentët e shkollës profesionale.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe vendosjen e një shtandi në Sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 1 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.